



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.132

18 dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9641
datë 20.11.2006

Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për
parandalimin e 5157
terrorizmit”.....

Ligj nr.9642
datë 20.11.2006

Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për masat
kundër trafikimit të qenieve 5169
njerëzore”.....

Ligj nr.9644
datë 20.11.2006

Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004
“Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar..... 5184

LIGJ
Nr.9641, datë 20.11.2006

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR PARANDALIMIN E
TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin e terrorizmit”, bërë në Varshavë më 16 maj 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5147, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR PARANDALIMIN E TERRORIZMIT

Varshavë, 16.5.2005
Seria e traktateve europiane ETS nr.196

HYRJE

Vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe vendet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente:
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të ngushtë midis shteteve anëtare të tij;

duke njohur vlerën e bashkëpunimit në rritje me Palët e tjera të kësaj Konvente;
me dëshirën për të marrë masa efektive për parandalimin e terrorizmit dhe në veçanti për përballimin e provokimit publik në lidhje me kryerjen e veprave penale me natyrë terroriste, si dhe rekrutimin dhe trajnimin për qëllime terrorizmin;

të ndërgjegjshme për shqetësimin e thellë të shkaktuar nga përhapja e mëtejshme e veprave penale me natyrë terroriste dhe nga kërcënimi terrorist në rritje;

të ndërgjegjshme për situatën e pasigurt ku ndodhen ata që vuajnë nga terrorizmi dhe, në këtë kontekst, duke rikonfirmuar solidaritetin e tyre të ngushtë me viktimat e terrorizmit dhe të familjeve të tyre;

duke pranuar që veprat penale me natyrë terroriste dhe veprat penale të tjera të parashtruara në këtë Konventë, nga kushdo që të jenë kryer, nuk mund të jenë, nën asnjë rrethanë, të justifikueshme nga asnjë arsye të natyrës politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo të ndonjë natyre tjetër të ngjashme dhe duke sjellë në kujtesë detyrimet e të gjitha Palëve për të parandaluar këto vepra penale dhe nëse nuk parandalohen, të ndiqen penalisht dhe të sigurohet që të jenë të ndëshkueshme me dënime, të cilat të marrin në konsideratë natyrën e tyre serioze;

duke sjellë në kujtesë nevojën e forcimit të luftës kundër terrorizmit dhe duke rikonfirmuar që të gjitha masat që merren për parandalimin apo luftimin e veprave penale me natyrë terroriste duhet të respektojnë shtetin ligjor dhe vlerat demokratike, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe

dispozita të tjera të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, edhe ligjin humanitar ndërkombëtar;

duke pranuar që kjo Konventë nuk ka si qëllim cenimin e parimeve të pranuar, për sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së anëtarësimit në shoqata;

duke sjellë në kujtesë që aktet e terrorizmit synojnë, sipas natyrës ose kontekstit, të kërcënojnë seriozisht një popullatë apo të detyrojnë padrejtësisht një qeveri apo një organizatë ndërkombëtare për kryerjen apo moskryerjen e një veprimi të caktuar, apo destabilizimin ose shkatërrimin e konsiderueshëm të strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore të një vendi apo organizate ndërkombëtare,

janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Termet e përdorur

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “vepër penale me natyrë terroriste” nënkupton çdo vepër penale brenda fushës së veprimit dhe siç është përkufizuar në një nga traktatet e listuara në shtojcën bashkëlidhur kësaj Konvente.

2. Me depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një shtet ose Komuniteti European, i cili nuk është Palë e një marrëveshjeje të listuar në shtojcën fundore të kësaj Konvente, mund të deklarojë që, në zbatimin e kësaj Konvente nga kjo Palë e interesuar, ajo marrëveshje do të çmohet të mos përfshihet në këtë shtojcë. Ky deklaram do të pushojë së pasuri efekt në kohën që marrëveshja hyn në fuqi për Palën që e bën këtë deklaram, e cila do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për këtë hyrje në fuqi.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Konvente është intensifikimi i përpjekjeve të Palëve në parandalimin e terrorizmit dhe pasojave të tij negative mbi gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtën për jetën, nëpërmjet masave të marra si në nivel kombëtar, ashtu edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë në konsideratë marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe në fuqi ose marrëveshjet midis Palëve.

Neni 3

Politikat kombëtare të parandalimit

1. Çdo Palë do të marrë masat e nevojshme, veçanërisht në fushën e trajnimit të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe organizmave të tjerë, si dhe në fushën e arsimit, kulturës, informacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të mediave dhe publikut, me synim parandalimin e veprave penale me natyrë terroriste dhe pasojave të tyre negative, duke respektuar njëkohësisht detyrimet për të drejtat e njeriut siç janë parashtruar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe detyrime të tjera nga ligji ndërkombëtar, nëse këto konventa apo marrëveshje janë të zbatueshme për atë Palë.

2. Çdo Palë do të marrë masa të nevojshme për përmirësimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare, me synim parandalimin e veprave penale me natyrë terroriste dhe pasojave të tyre negative, ndër të tjera, nëpërmjet:

- a) shkëmbimit të informacionit;
- b) përmirësimit të mbrojtjes fizike të personave dhe objekteve;
- c) zhvillimit të trajnimit dhe planeve të koordinimit për emergjencat civile.

3. Çdo Palë do të nxisë tolerancë nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të dialogut ndërfetar dhe mbarëkulturar, duke përfshirë, aty ku është e mundur, organizmat joqeveritarë dhe elemente të tjera të shoqërisë civile, me synim parandalimin e tensioneve që mund të ndikojnë në kryerjen e veprave penale me natyrë terroriste.

4. Çdo Palë do të bëjë përpjekje për nxitjen e ndërgjegjësimit publik për sa i përket ekzistencës, shkaqeve dhe rëndësisë së kërcënimit që vjen nga veprat penale me natyrë terroriste dhe ato të parashtruara në këtë Konventë, si dhe të mbajë në konsideratë nxitjen e publikut për të vënë në dispozicion fakte, ndihmë të veçantë ndaj autoriteteve kompetente që mund të kontribuojnë në parandalimin e veprave penale me natyrë terroriste, si dhe të atyre të parashtruara në këtë Konventë.

Neni 4

Bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me parandalimin

Sipas rastit dhe në përputhje me kapacitetet e tyre, Palët do të ndihmojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën, me synim zhvillimin e kapaciteteve të tyre për parandalimin e kryerjes së veprave penale me natyrë terroriste, me anë të shkëmbimit të informacionit dhe praktikave të tyre më të mira, si dhe me anë të trajnimit dhe përpjekjeve të tjera të përbashkëta të karakterit parandalues.

Neni 5

Provokimi publik për kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste

1. Për qëllime të kësaj Konvente, “provokimi publik për kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste” nënkupton shpërndarjen ose ndryshe vënien në dispozicion të një mesazhi për publikun, me qëllim nxitjes e kryerjes së një vepre penale me natyrë terroriste, ku një sjellje e tillë, megjithëse mund të mos nënkuptojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbështetjen e veprave penale me natyrë terroriste, rrezikon kryerjen e një apo më shumë veprave të tilla.

2. Çdo Palë do të miratojë masa, që çmohen të nevojshme, për ta klasifikuar provokimin publik për kryerjen e veprës penale me natyrë terroriste në ligjet e saj kombëtare si vepër penale të natyrës terroriste, sipas përkufizimit të paragrafit 1 të këtij neni, kur kryhet në mënyrë të paligjshme dhe me dashje.

Neni 6

Rekrutimi për qëllime terrorizmi

1. Për qëllime të kësaj Konvente, “rekrutim për qëllime terrorizmi” nënkupton kërkesën ndaj një personi tjetër për të kryer apo marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste ose anëtarësimin në një shoqatë apo grup, me qëllim ndihmën për kryerjen e një apo më shumë veprave penale terroriste nga ana e shoqatës apo e grupit.

2. Çdo Palë do të miratojë masa sipas kushteve të nevojshme, për ta klasifikuar rekrutimin për qëllime terrorizmi në ligjet e saj të brendshme si një vepër penale të natyrës terroriste, sipas përkufizimit të paragrafit 1 të këtij neni, kur kryhet në mënyrë të paligjshme dhe me dashje.

Neni 7

Trajnimi për qëllime terrorizmi

1. Për qëllime të kësaj Konvente, “trajnimi për qëllime terrorizmi” nënkupton dhënien e udhëzimeve për përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit ose armëve të tjera apo substancave të dëmshme dhe të rrezikshme, ose të teknikave dhe metodave të tjera të specifike, me synim kryerjen apo ndihmën për kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste, duke pasur dijeni që aftësitë e dhëna synojnë të përdoren për arritjen e këtij qëllimi.

2. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme, sipas nevojës, për ta klasifikuar trajnimin për qëllime terrorizmi në ligjet e saj të brendshme si një vepër penale të natyrës terroriste, siç përkufizohet në paragrafin 1 të këtij neni, kur kryhet në mënyrë të paligjshme dhe me dashje.

Neni 8

Papërputhshmëria e kryerjes së një vepre penale me natyrë terroriste

Në mënyrë që një veprim të përbëjë një vepër penale sipas klasifikimit të neneve 5 deri 7 të kësaj Konvente, nuk është e nevojshme që të kryhet një vepër penale me natyrë terroriste.

Neni 9

Veprat penale të ndërvarura

1. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për t'i klasifikuar në legjislacionin kombëtar si vepra penale të natyrës terroriste, edhe veprat e mëposhtme:

a) Pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një vepër penale, siç përcaktohet në nenet 5 deri 7 të kësaj Konvente;

b) Organizimin ose urdhërimin e të tjerëve për kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në nenet 5 deri 7 të kësaj Konvente;

c) Në ndihmën për kryerjen e një apo më shumë veprave penale, sipas përcaktimit të neneve 5 deri në 7 të kësaj Konvente, nga një grup personash që veprojnë nën një qëllim të përbashkët, kjo ndihmë do të jetë e qëllimshme, si dhe:

i) do të bëhet me synim zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë kriminale ose qëllimit kriminal të grupit, ku kjo veprimtari ose qëllim përfshin kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në nenet 5 deri 7 të kësaj Konvente;

ii) ose do të bëhet në kontekstin e njohjes së qëllimeve të grupit për kryerjen e veprave penale, siç përcaktohet në nenet 5 në 7 të kësaj Konvente.

2. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për të klasifikuar si vepër penale në legjislacionin kombëtar tentativën për të kryer një vepër penale, sipas përcaktimit të bërë në nenet 6 dhe 7 të kësaj Konvente.

Neni 10

Përgjegjësitë e subjekteve juridike

1. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme në përputhje me parimet e saj ligjore, për të vendosur përgjegjësitë e subjekteve juridike për pjesëmarrjen në vepër penale, siç parashikohen në nenet 5 deri 7 dhe 9 të kësaj Konvente.

2. Bazuar në parimet ligjore të secilës Palë, përgjegjësia e subjekteve ligjore mund të jetë penale, civile ose administrative.

3. Kjo përgjegjësi nuk do të cenojë përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprat penale.

Neni 11

Sanksionet dhe masat

1. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme, në mënyrë që veprat penale të përcaktuara në nenet 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente të dënohen nëpërmjet dënimeve efektive, proporcionale dhe bindëse.

2. Dënimet e mëparshme të formës së prerë të dhëna në shtetet e huaja për sa i përket veprave penale të parashikuara në këtë Konventë, mund të merren në konsideratë në masën që e lejon legjislacioni kombëtar, në lidhje me përcaktimin e masës së dënimit në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Çdo Palë do të sigurojë që subjektet juridike që janë përgjegjëse sipas nenit 10, t'u nënshtrohen sanksioneve penale ose jopenale, efektive, proporcionale dhe bindëse, përfshirë edhe sanksionet financiare.

Neni 12
Kushtet dhe garancitë

1. Çdo Palë do të sigurojë që krijimi, ekzekutimi dhe zbatimi i kriminalizimit sipas neneve 5 deri 7 dhe 9 të kësaj Konvente, të kryhen duke respektuar detyrimet për të drejtat e njeriut, në veçanti të drejtat për lirinë e shprehjes, lirinë e anëtarësimit në shoqata dhe lirinë e fesë, si Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe detyrime të tjera nga ligji ndërkombëtar, nëse këto Konventa apo Marrëveshje janë të zbatueshme nga kjo Palë.

2. Për më tepër, krijimi, ekzekutimi dhe zbatimi i kriminalizimit të veprës penale sipas nenit 5 deri në 7, si dhe 9 të kësaj Konvente, duhet t'i nënshtrohet parimeve të proporcionalitetit, për sa u përket qëllimeve legjitime të ndjekura dhe të domosdoshmërisë së tyre në një shoqëri demokratike dhe duhet të përjashtojnë çdo formë arbitrariteti apo trajtim diskriminues ose racist.

Neni 13
Mbrojtja, kompensimi dhe mbështetja ndaj viktimave të terrorizmit

Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të veprave të terrorizmit të kryera brenda territorit të saj. Ndër të tjera, këto masa, bazuar në skema të përshtatshme kombëtare dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, mund të përfshijnë edhe ndihmë financiare dhe kompensim për viktimat e terrorizmit dhe pjesëtarët të afërm të familjeve të tyre.

Neni 14
Juridiksioni

1. Çdo Palë do të marrë masa legjislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të vendosur juridiksionin mbi çdo veprë penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente:

- a) kur vepra është kryer në territorin e saj ose
- b) kur vepra është kryer në bordin e një anijeje që ngre flamurin e asaj Pale ose në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj Pale; ose
- c) kur vepra është kryer nga një prej shtetasve të saj ose nga një person pa shtetësi që ka banesën e tij ose të saj të përhershme në territorin e saj, nëse vepra është e dënueshme sipas së drejtës penale në vendin ku është kryer ose nëse vepra është kryer jashtë juridiksionit territorial të një shteti.

2. Çdo Palë mund të vendosë juridiksionin e vet mbi çdo veprë penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente:

- a) kur vepra synohet ose rezultonte në kryerjen e një veprë penale të referuar në nenin 1 të kësaj Konvente në territorin ose kundër një shtetasi të asaj Pale;
- b) kur vepra synohet ose rezultonte në kryerjen e një veprë penale të referuar në nenin 1 të kësaj Konvente kundër një objekti shtetëror ose qeveritar të asaj Pale jashtë vendit, duke përfshirë edhe ambientet e godinave konsullore dhe diplomatike të asaj Pale; ose
- c) kur vepra synohet ose rezultonte në kryerjen e një veprë penale të referuar në nenin 1 të kësaj Konvente, e kryer me tentativën për të detyruar atë Palë në kryerjen ose frenimin e kryerjes së ndonjë veprimi; ose
- d) kur vepra është kryer nga një person pa shtetësi që ka banesën e tij ose të saj të përhershme në territorin e saj; ose
- e) kur vepra është kryer në bordin e një avioni, i cili operohet nga qeveria e asaj Pale.

3. Çdo Palë do të miratojë masa sipas nevojës për të vendosur juridiksion mbi veprat penale të referuara në këtë Konventë, në rastet kur një shkelës i dyshuar është i pranishëm në territorin e saj dhe pas një kërkesë për ekstradim, nuk e ekstradon atë te një Palë tjetër, juridiksioni i së cilës mbështetet në të njëjtin juridiksion ligjor si ai i Palës, së cilës i kërkohet ekstradimi.

4. Kjo Konventë nuk përjashton juridiksionin penal të ushtruar nga një Palë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

5. Kur më shumë se një Palë kërkon juridiksion mbi një vepër penale të dyshuar të përcaktuar sipas kësaj Konvente, Palët e përfshira do të konsultohen, sipas nevojës, me qëllim vendosjen e juridiksionit më të përshtatshëm për ndjekjen penale.

Neni 15 **Detyra për të hetuar**

1. Me marrjen e njoftimit që një person, i cili ka kryer ose supozohet të ketë kryer një vepër penale të parashikuar nga kjo Konventë, mund të ndodhet në territorin e saj, Pala e interesuar do të marrë masat e nevojshme sipas legjislacionit të brendshëm për të hetuar faktet që përmban ky informacion.

2. Me bindjen se rrethanat e kërkojnë këtë, Pala në territorin e së cilës kriminelin ose personin i dyshuar si kriminel është i pranishëm në territorin e saj, do të marrë masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin e brendshëm, në mënyrë që të sigurojë praninë e atij personi për ndjekje penale apo ekstradim.

3. Çdo personi, ndaj të cilit janë marrë masat që parashikohen në paragrafin 2, do t'i jepet e drejta:

a) për të komunikuar pa vonesë me përfaqësuesin më të afërt të shtetit, shtetas i të cilit ai është ose të atij shteti që i jepet e drejta për të mbrojtur të drejtat e tij ose nëse ai person është pa shtetësi, me shtetin në territorin e të cilit ky person ka banesën e përhershme;

b) për t'u vizituar nga një përfaqësues i atij shteti;

c) për t'u informuar për të drejtat e atij personi sipas nënparagrafit a dhe b.

4. Të drejtat që referohen mbi bazën e paragrafit 3 do të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Palës, në territorin e së cilës autori i veprës penale ose personi i dyshuar si i tillë është i pranishëm, duke iu nënshtruar dispozitës se ligjet dhe rregulloret e sipërpërmendura duhet të kenë efekt të plotë ndaj qëllimeve për të cilat synohen të drejtat e dhëna sipas paragrafit 3.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk do të cenojnë të drejtën e asnjë Pale që ka një kërkesë juridiksioni në përputhje me nenin 14, paragrafët 1.d dhe 2.d, për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të komunikuar me personin e supozuar për kryerjen e veprës penale dhe për ta vizituar atë.

Neni 16 **Moszbatimi i Konventës**

Kjo Konventë nuk zbatohet kur një vepër penale e përcaktuar në përputhje me nenet 5 deri 7, si dhe 9 është kryer brenda një shteti të vetëm, kur personi i dyshuar për veprën penale është shtetas i atij vendi dhe është i pranishëm në territorin e atij shteti, dhe asnjë shtet tjetër nuk bazohet në nenin 14, paragrafi 1 ose 2, të kësaj Konvente, për të ushtruar juridiksion, duke nënkuptuar që dispozitat e nenit 17 dhe ato të neneve 20 deri 22 të kësaj Konvente do të zbatohen sipas nevojës në këto raste.

Neni 17 **Bashkëpunimi ndërkombëtar për çështje penale**

1. Palët do t'i japin njëra-tjetrës ndihmën maksimale në lidhje me hetimet ose procedurat penale dhe ato të ekstradimit, për sa i përket veprave penale të parashtruara në nenet 5 dhe 7 të kësaj Konvente, duke përfshirë edhe ndihmën në gjetjen e provave që mund të kenë në dispozicion, të nevojshme për procedimin e këtyre veprave penale.

2. Palët do të përmbushin detyrimet e tyre të paragrafit 1, në përputhje me çdo traktat ose marrëveshje tjetër mbi ndihmën e ndërsjellë juridike që mund të ekzistojë midis tyre. Në mungesë të këtyre traktateve apo marrëveshjeve, Palët do ta ndihmojnë njëra-tjetrën, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në nivelin maksimal të mundshëm mbi bazën e ligjit përkatës, traktateve, marrëveshjeve apo rregullimeve të tjera ligjore të Palës së kërkuar, për sa i përket hetimit penal apo procedimeve në lidhje me veprat penale për të cilat një person juridik mund të jetë përgjegjës në përputhje me nenin 10 të kësaj Konvente, në Palën kërkuuese.

4. Çdo Palë mund të shqyrtojë krijimin e mekanizmave shtesë për të shkëmbyer me Palët e tjera informacion ose prova që, në zbatim të nenit 10, nevojiten për vendosjen e përgjegjësisë penale, civile apo administrative.

Neni 18

Ekstradimi ose ndjekja penale

1. Pala, në territorin e së cilës është i pranishëm personi që dyshohet të ketë kryer veprën penale, kur ka juridiksion në përputhje me nenin 14, nëse nuk e ekstradon atë person, pa asnjë lloj përjashtimi dhe nëse vepra penale është kryer ose jo në territorin e saj, do të jetë e detyruar t'ua paraqesë çështjen penale autoriteteve kompetente pa asnjë vonesë të pajustificueshme, me qëllim ndjekjen penale nëpërmjet procedurave që janë në përputhje me legjislacionin e atij vendi. Ato autoritete kompetente duhet të marrin vendimet e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo vepre tjetër të rëndë penale, sipas legjislacionit të asaj Pale.

2. Sa herë që një Palë i lejohet nga legjislacioni i saj i brendshëm të ekstradojë apo edhe të dorëzojë një shtetas të saj me kusht që personi do t'i rikthehet asaj Pale për të vuajtur dënimin e dhënë si rezultat i procesit gjyqësor apo i procedimit penal për të cilin ekstradimi apo dorëzimi i personit është kërkuar, dhe kjo Palë si dhe Pala tjetër që ka kërkuar ekstradimin e personit bien dakord me këtë zgjedhje dhe me kushte të tjera që mund të çmohen të nevojshme, një ekstradim i tillë i kushtëzuar apo dorëzim i personit do të jenë të mjaftueshëm për çlirimin nga detyrimi që parashikohet në paragrafin 1.

Neni 19

Ekstradimi

1. Veprat penale të parashtruara në nenin 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente do të çmohen si të përfshira në veprat penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që mund të ekzistojë midis secilës prej Palëve, para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Palët do të marrin masat e nevojshme për përcaktimin e këtyre veprave penale si vepra penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që mund të bëhet më pas midis tyre.

2. Kur një Palë, e cila bën ekstradim të kushtëzuar në bazë të një marrëveshjeje, merr një kërkesë ekstradimi nga një Palë tjetër, me të cilën ajo nuk ka marrëveshje ekstradimi, atëherë Pala e kërkuar, mbi bazën e vendimit që merr, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradim në lidhje me veprat penale që parashikohen në nenet 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente. Ekstradimi do t'u nënshtrohet kushteve të tjera, të cilat parashikohen nga ligji i Palës së kërkuar.

3. Palët që nuk bëjnë ekstradim të kushtëzuar mbi bazën e një marrëveshjeje, do t'i njohin veprat penale të parashikuara në nenet 5 deri 7 dhe 9 të kësaj Konvente si vepra penale të ekstradueshme midis tyre, duke iu nënshtuar kushteve të parashikuara nga ligji i Palës së kërkuar.

4. Kur është e nevojshme, për qëllime ekstradimi midis Palëve, veprat penale të parashikuara në nenet 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente, do të trajtohen sikur të mos jenë kryer vetëm në vendin ku ato kanë ndodhur, por edhe në territoret e Palëve, të cilat e kanë miratuar juridiksionin në përputhje me nenin 14.

5. Dispozitat e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve të ekstradimit të hartuara midis Palëve në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet nga 5 deri në 7, si dhe 9 të kësaj Konvente, do të çmohen si të modifikuara midis Palëve në masën që ato janë të papajtueshme me këtë Konventë.

Neni 20

Përcaktimi i klauzolës së përjashtimit politik

1. Asnjë prej veprave penale që referohen në nenet 5 deri në 7, si dhe 9 të kësaj Konvente, për qëllime ekstradimi ose ndihme të ndërsjellë juridike, nuk do të çmohet si një vepër penale politike, si krim i lidhur me një vepër penale politike ose si vepër penale e shtyrë nga motive politike. Për rrjedhojë, një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë të ndërsjellë juridike, e bazuar në një vepër të tillë penale, mund të mos refuzohet për arsyen e vetme se ka lidhje me një vepër penale politike ose me një krim të lidhur me një vepër penale politike apo me një vepër penale të shtyrë nga motive politike.

2. Pa cenuar zbatimin e neneve 19 deri 23 të Konventës së Vjenës mbi Ligjin e Marrëveshjeve, të 23 majit 1969 ndaj neneve të tjera të kësaj Konvente, çdo shtet ose Komuniteti Europian, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në Konventë, mund të deklarojë se rezervon të drejtën e moszbatimit të paragrafit 1 të këtij neni për sa i përket ekstradimit për një vepër penale të parashtruar në këtë Konventë. Pala ndërmerr të zbatojë këtë rezervë rast pas rasti, nëpërmjet një vendimi të mirarsyetuar.

3. Në përputhje me paragrafin 2, çdo Palë mund të bëjë një rezervë, pjesërisht apo tërësisht, nëpërmjet një deklarimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili hyn në fuqi në datën e konfirmimit të marrjes së tij.

4. Një Palë e cila ka bërë rezervë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, mund të mos kërkojë zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni nga çdo Palë tjetër; por bazuar në faktin nëse rezerva e saj është e pjesshme apo e plotë, mund të kërkojë zbatimin e këtij neni për atë pjesë të cilën e ka pranuar vetë.

5. Për sa i përket Palës së interesuar, rezerva do të jetë e vlefshme për një periudhë trevjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Megjithatë, kjo rezervë mund të rinovohet për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

6. Dymbëdhjetë muaj para datës së përfundimit të rezervës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Palën e interesuar në lidhje me mbarimin e afatit. Jo më vonë se tre muaj para datës së mbarimit të afatit, Pala e interesuar do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës nëse ajo do të mbështesë, amendojë apo tërheqë rezervën e saj. Kur një Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës që mbështet rezervën e saj, ajo duhet të japë një sqarim në lidhje me arsyet që argumentojnë vazhdimin e rezervës. Në mungesë të njoftimit nga Pala e interesuar, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të informojë atë Palë që rezerva e saj konsiderohet automatikisht e shtyrë për një periudhë gjashtëmuajore. Mungesa e mëtejshme e njoftimit nga ana e Palës së interesuar për qëllimet e saj për të mbështetur apo modifikuar rezervën e saj para mbarimit të kësaj periudhe, çon në mbarimin e afatit të rezervës.

7. Kur një Palë nuk ekstradon një person në zbatim të kësaj rezerve, pas marrjes së një kërkesë ekstradimi nga një Palë tjetër, ajo duhet t'ua paraqesë këtë çështje penale autoriteteve kompetente, pa asnjë lloj përjashtimi dhe pa asnjë vonesë të paargumentuar, me qëllim ndjekjen penale, përveçse në rastet kur Pala kërkuese dhe Pala e kërkuar bien dakord ndryshe. Për qëllime të ndjekjes penale në Palën e kërkuar, autoritetet kompetente do t'i marrin vendimet e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo vepre të rëndë penale, sipas legjislacionit të asaj Pale. Pala e kërkuar do ta komunikojë, pa vonesa të pajustificueshme, rezultatin përfundimtar të procedimit penal Palës kërkuese dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili e paraqet atë më tej për t'iu nënshtruar konsultimit së Palëve, siç parashikohet në nenin 30.

8. Vendimi për të refuzuar një kërkesë ekstradimi, mbi bazën e kësaj rezerve, do t'i paraqitet menjëherë Palës kërkuese. Nëse brenda një kohe të arsyeshme, nuk është arritur asnjë vendim gjyqësor në themel në Palën e kërkuar për çështjen në fjalë, sipas paragrafit 7, Pala kërkuese mund t'ia komunikojë këtë fakt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili mund t'ia paraqesë këtë çështje më tej për t'iu nënshtruar konsultimit të Palëve, siç parashikohet në nenin 30. Ky konsultim do të marrë në konsideratë çështjen dhe do të japë një mendim në lidhje me pajtueshmërinë e refuzimit me Konventën dhe do t'ia paraqesë atë Komitetit të Ministrave, me qëllim lëshimin të një deklarate në përputhje me atë mendim. Gjatë kryerjes së funksioneve sipas këtij paragrafi, Komiteti i Ministrave do të mblidhet me përbërje të kufizuar vetëm nga Shtetet Palë.

Neni 21

Çështja e diskriminimit

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për ekstradim apo i ndihmës së ndërsjellë juridike, nëse Pala e kërkuar ka arsye të forta për të besuar se kërkesa për ekstradim për vepra penale të parashikuara në nenet 5 deri në 7 dhe 9 ose ndihma e ndërsjellë juridike në lidhje me vepra penale të kësaj natyre është bërë me qëllimin e ndjekjes penale dhe dënimit të një personi për arsye të lidhura me racën, fenë, kombësinë, origjinën etnike apo opinionet politike të tij, ose zbatimi i kërkesës mund të cenojë pozicionin e atij personi për ndonjë prej arsyeve të mësipërme.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për ekstradim,

nëse personi për të cilin është bërë kërkesa për ekstradim rrezikon t'i nënshtrohet torturës ose dënimit dhe trajtimit çnjerëzor degradues.

3. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për ekstradim, nëse personi për të cilin është bërë kërkesa për ekstradim, rrezikon t'i nënshtrohet dënimit me vdekje ose kur ligji i Palës së kërkuar nuk merr parasysh dënimin me burgim të përjetshëm, si dhe të burgimit të përjetshëm pa mundësinë e lirit të përkohshëm me kusht, përveçse në rastet kur në kushtet e marrëveshjeve ekzistuese të ekstradimit, Pala e kërkuar ndodhet nën detyrimin e ekstradimit nëse Pala kërkuuese jep garanci që çmohen të mjaftueshme nga Pala e kërkuar që dënimi me vdekje nuk do të zbatohet, ose nëse do të zbatohet, nuk do të kryhet, ose që personi në fjalë nuk do të dënohet me burgim të përjetshëm pa iu dhënë mundësia e lirit të përkohshëm me kusht.

Neni 22

Informacionet spontane

1. Pa cenuar hetimet dhe procedimet penale të tyre, autoritetet kompetente të një Pale, pa ndonjë kërkesë paraprake, mund t'i dërgojnë informacion autoriteteve përkatëse të një Pale tjetër që mund të jetë mbledhur në kuadrin e hetimit të bërë nga kjo Palë dhe kur çmohet se vënia në dispozicion e këtij informacioni mund ta ndihmojë Palën që merr informacionin në lidhje me fillimin ose kryerjen e hetimit apo të procedimit penal, ose që mund të çojë në bërjen e një kërkesë nga kjo Palë mbi bazën e dispozitave të kësaj Konvente.

2. Pala që vë në dispozicion informacionin, në zbatim të legjislacionit të saj të brendshëm, mund të vendosë kushte mbi përdorimin e një informacioni të tillë nga ana e Palës që merr informacionin.

3. Pala që merr informacionin do të respektojë kushtet e vëna nga Pala që vë në dispozicion këtë informacion.

4. Megjithatë, çdo Palë, në çdo kohë, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë që rezervon të drejtën për të mos respektuar kushtet e vendosura nga Pala që ka vënë në dispozicion informacionin mbi bazën e paragrafit 2 më sipër, përveçse në rastet kur ajo merr njoftim paraprak mbi natyrën e informacionit që vihet në dispozicion dhe bie dakord me dërgimin e tij.

Neni 23

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe për shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës kur gjashtë shtete nënshkruese, nga të cilat të paktën katër janë shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

4. Për çdo shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për të respektuar këtë Konventë, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së shprehjes së pëlqimit për ta respektuar Konventën në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

Neni 24

Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit me Shtetet Palë të Konventës dhe miratimit të tyre unanim, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, për të aderuar në këtë Konventë me anë të një vendimi që merret me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me unanimitetin e përfaqësuesve të Shteteve Palë që gëzojnë të drejtën e anëtarit të Komitetit të Ministrave.

2. Për çdo shtet aderues në Konventë, në përputhje me paragrafin 1 më sipër, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 25

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në çdo datë tjetër të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Konventa do të hyjë në fuqi për këtë territor ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Çdo deklaratë, në lidhje me ndonjë territor të përcaktuar në deklaratë, e bërë në bazë të dy paragrafëve paraardhës, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 26

Efektet e Konventës

1. Kjo Konventë shërben si shtesë e traktateve dhe marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në fuqi midis Palëve, duke përfshirë dhe dispozitat e traktateve të mëposhtme të Këshillit të Europës:

- Konventa europiane mbi ekstradimin, e hapur për nënshkrim në Paris, më 13 dhjetor 1957 (ETS nr.24).

- Konventa europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, e hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 20 prill 1959 (ETS nr. 30).

- Konventa europiane mbi luftën kundër terrorizmit, e hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 27 janar 1977 (ETS nr.90).

- Protokolli shtesë i konventës europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, i hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 17 mars 1978 (ETS nr.99).

- Protokolli i dytë shtesë i konventës europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, i hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 8 nëntor 2001 (ETS nr.182).

- Protokolli që amendon konventën europiane mbi luftën kundër terrorizmit, i hapur për nënshkrim në Strasburg, më 15 maj 2003 (ETS nr.190).

2. Nëse dy ose më shumë Palë kanë lidhur një marrëveshje apo traktat mbi çështjet e trajtuara në këtë Konventë, kanë krijuar marrëdhënie të tjera mbi këto çështje apo parashikojnë ta bëjnë një gjë të tillë në të ardhmen, do të jenë të autorizuar të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat apo të rregullojnë marrëdhëniet e tyre në përputhje me atë qëllim. Megjithatë, kur Palët krijojnë marrëdhëniet e tyre në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ndryshe nga ato që janë trajtuar në të, do t'i rregullojnë këto çështje në mënyrë të tillë që të mos bien ndesh me parimet dhe objektivat e kësaj Konvente.

3. Palët të cilat janë anëtare të Bashkimit Europian, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, do të zbatojnë rregulloret e Komunitetit dhe Bashkimit Europian për sa kohë që ka në fuqi rregulloret të Komunitetit dhe të Bashkimit Europian që rregullojnë çështje të interesit specifik dhe të zbatueshme për çdo rast të veçantë, pa cenuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente dhe pa cenuar zbatimin e plotë të saj ndaj Palëve të tjera.

4. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ketë efekte mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të një Pale apo të individëve, të parashikuara në legjislacionin ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe ligjin humanitar ndërkombëtar.

5. Veprimtaritë e Forcave të Armatosura gjatë një konflikti të armatosur, siç ato terma kuptohen sipas ligjit humanitar ndërkombëtar dhe që rregullohen nga ai ligj, nuk rregullohen nga kjo

Konventë dhe veprimtaritë e ndërmarra nga forcat ushtarake të një Pale në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare, në shkallën që ato rregullohen nga rregullore të tjera të ligjit ndërkombëtar, nuk rregullohen nga kjo Konventë.

Neni 27

Amendamentet ndaj Konventës

1. Amendamentet ndaj kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ose Konsultimi ndërmjet Palëve.

2. Çdo propozim për amendament do t'u komunikohet Shteteve Palë të kësaj Konvente nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Për më tepër, amendamenti i propozuar nga një Palë ose Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës i komunikohet Grupit Konsultues ndërmjet Palëve, i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e vet për amendamentin e propozuar.

4. Komiteti i Ministrave do të shqyrtojë amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Grupi Konsultues ndërmjet Palëve dhe mund të miratojë amendamentin në fjalë.

5. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni do t'u transmetohet Palëve për pranim.

6. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pasi të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se e kanë pranuar atë.

Neni 28

Rishikimi i shtojcës

1. Me qëllim përditësimin e listës së traktateve në shtojcën bashkëlidhur, mund të propozohen amendime nga secila Palë ose nga Komiteti i Ministrave. Këto propozime për amendime do të përfshijnë vetëm marrëveshjet universale të lidhura brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara që merren kryesisht me terrorizmin ndërkombëtar dhe që kanë hyrë në fuqi. Ato do t'u komunikohen Palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Pas konsultimit me Palët joanëtare, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të miratojë një amendim të propozuar nga shumica, siç parashikohet në nenin 20 pika "d" të Statutit të Këshillit të Europës. Amendimi do të hyjë në fuqi në vijim të përfundimit të periudhës prej 1 viti nga data që ai u është dërguar Palëve. Gjatë kësaj periudhe, çdo Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për kundërshtime të mundshme për hyrjen në fuqi të atij amendimi në lidhje me atë Palë.

3. Nëse një e treta e Palëve e njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës mbi një kundërshtim për hyrjen në fuqi të amendimit, ky i fundit nuk do të hyjë në fuqi.

4. Nëse më pak se një e treta e Palëve njoftojnë në lidhje me një kundërshtim, amendimi do të hyjë në fuqi për ato Palë, të cilat nuk kanë bërë njoftim për atë kundërshtim.

5. Kur amendimi ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 2 dhe një Palë ka shprehur kundërshtim për atë amendim, atëherë ky amendim do të hyjë në fuqi për sa i përket Palës në fjalë e cila nuk e ka pranuar atë, në ditën e parë të muajit, në vijim të datës në të cilën ajo Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për pranimin e tij.

Neni 29

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e një mosmarrëveshjeje midis dy ose më shumë Palëve përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente, Palët në fjalë do të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet nëpërmjet bisedimit ose çdo zgjidhjeje tjetër paqësore sipas zgjedhjes së tyre, përfshirë këtu paraqitjen e mosmarrëveshjes para një gjykate arbitrazhi, vendimet e së cilës do të jenë të detyrueshme për Palët ose paraqitjen e mosmarrëveshjes para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë siç mund të bihet dakord

nga Palët në fjalë.

Neni 30

Konsultimi ndërmjet Palëve

1. Palët do të konsultohen në mënyrë periodike me synim:
 - a) bërjen e propozimeve për të lehtësuar ose përmirësuar përdorimin efektiv dhe zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e çdo problemi dhe efektet e çdo deklarami të bërë në kuadrin e kësaj Konvente;
 - b) formulimin e opinionit mbi pajtueshmërinë e një refuzimi për të ekstraduar, i cili u referohet atyre në përputhje me nenin 20 paragrafi 8;
 - c) bërjen e propozimeve për amendimin e kësaj Konvente në përputhje me nenin 27;
 - d) formulimin e opinionit mbi çdo propozim për amendimin e kësaj Konvente, i cili i referohet atyre në përputhje me nenin 27 paragrafi 3;
 - e) shprehjen e një opinionit mbi çdo çështje që i përket zbatimit të kësaj Konvente dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mbi zhvillime të ndjeshme në fushën ligjore, politike apo teknologjike.
2. Konsultimet e Palëve do të bëhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës kurdoherë që ai e çmon të nevojshme dhe në çdo rast, kur një shumicë e Palëve ose e Komitetit të Ministrave kërkon mbledhjen e tij.
3. Palët do të asistohen nga Sekretariati i Këshillit të Europës gjatë kryerjes së funksioneve të tyre në zbatim të këtij neni.

Neni 31

Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë, duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Denoncimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 32

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet që ka nënshkruar këtë Konventë, çdo Shtet Palë, Komunitetin European, çdo shtet që është ftuar ta nënshkruajë këtë Konventë, si dhe çdo shtet që është ftuar të aderojë në këtë Konventë në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
 - b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit;
 - c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e nenit 23 të saj;
 - d) çdo deklaratë të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 1 paragrafi 2, nenit 22 paragrafi 4 dhe nenit 25;
 - e) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.
- Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Varshavë, më 16 maj 2005, në një origjinal të vetëm në gjuhët frënge dhe angleze, të dyja tekstet njëlloj të besueshme, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u dërgojë një kopje të vërtetuar secilit prej Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetit European, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës, si dhe çdo shteti tjetër të ftuar për të aderuar në të.

SHTOJCA

1. Konventa për ndalimin e sekuestrimit të paligjshëm të avionëve, nënshkruar në Hagë, më 16 dhjetor 1970.
2. Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së aviacionit civil, e lidhur në Montreal, më 23 shtator 1971.
3. Konventa për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave penale ndaj personave të mbrojtur në nivel ndërkombëtar, përfshirë agjentët diplomatikë, e miratuar në Nju-Jork, më 14 dhjetor 1973.
4. Konventa ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve, e miratuar në Nju-Jork, më 17 dhjetor 1979.
5. Konventa për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore, e miratuar në Vjenë, më 3 mars 1980.
6. Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme të dhunës në aeroportet e shërbimit të aviacionit civil ndërkombëtar, i lidhur në Montreal, më 24 shkurt 1988.
7. Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së lundrimit detar, i lidhur në Romë, më 10 mars 1988.
8. Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së platformave të palëvizshme të bregut kontinental, i lidhur në Romë më 10 mars 1988.
9. Konventa ndërkombëtare për ndalimin e bombardimeve të terrorizmit, e miratuar në Nju-Jork, më 15 dhjetor 1997.
10. Konventa ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, e miratuar në Nju-Jork, më 9 dhjetor 1999.

LIGJ

Nr.9642, datë 20.11.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR MASAT KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5148, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA

E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR MASAT KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Varshavë, 16.5.2005
Seria e traktateve europiane ETS nr.197

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente, duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të saj;

duke pasur në konsideratë që trafikimi i qenieve njerëzore përbën një shkelje të të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit dhe të integritetit të qenieve njerëzore;

duke pasur në konsideratë që trafikimi i qenieve njerëzore mund të rezultojë në skllavërinë për viktimat;

duke pasur parasysh që respekti për të drejtat e viktimave, mbrojtja e viktimave dhe masat për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore duhet të jenë objektiva parësorë;

duke marrë në konsideratë që të gjitha masat ose iniciativat kundër trafikimit të qenieve njerëzore duhet të jenë jodiskriminuese, duhet të marrin parasysh barazinë gjinore, si dhe një përqasje të të drejtave të fëmijëve;

duke sjellë ndër mend deklaratat e Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve anëtare në sesionin e 112-të të Komitetit të Ministrave (14-15 maj 2003) dhe të 114-të (12-13 maj 2004), që kërkonin përf forcimin e masave nga ana e Këshillit të Europës, në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore;

duke sjellë ndër mend Konventën për mbrojtjen e qenieve njerëzore e të lirive themelore (1950) dhe protokollet e saj;

duke pasur parasysh rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave ndaj shteteve anëtare të Këshillit të Europës: Rekomandimin nr.R (91) 11 mbi shfrytëzimin seksual, pornografinë dhe prostitucionin, trafikimin e fëmijëve dhe të rinjve; Rekomandimin nr.R (97) 13 në lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes; Rekomandimin nr.R (2000) 11 mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe Rekomandimin Rec (2001) 16 mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual; Rekomandimin Rec (2002) 5 mbi mbrojtjen e grave nga dhuna;

duke sjellë ndër mend rekomandimet e mëposhtme të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës: Rekomandimin 1325 (1997) mbi trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar në shtetet anëtare të Këshillit të Europës; Rekomandimin 1450 (2000) mbi dhunën kundër grave në Europë; Rekomandimin 1545 (2002) mbi një fushatë kundër trafikimit të grave; Rekomandimin 1610 (2003) mbi migrimin në lidhje me trafikimin e grave dhe prostitucionin; Rekomandimin 1611 (2003) mbi trafikimin e organeve në Europë; Rekomandimin 1663 (2004) Skllavëria në familje: skllavëria, ndihmëset shtëpiake dhe bashkëshortet e porositura nëpërmjet postës;

duke sjellë ndër mend projektvendimin e Këshillit të Bashkimit European të datës 19 korrik 2002 mbi luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, projektvendimin e Këshillit të Bashkimit European të datës 15 mars 2001 mbi pozicionin e viktimave në procedimet penale dhe udhëzimin e Këshillit të Bashkimit European të datës 29 prill 2004 mbi lejen e qëndrimit të lëshuar shtetasve të vendeve të treta, të cilët janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë objekt i një veprimi për lehtësimin e emigrimit ilegal, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente;

duke marrë parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe protokollin e saj mbi parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, me qëllim përmirësimin e mbrojtjes që ata mund të ofrojnë dhe zhvillimin e standardeve të vendosura nga to;

duke marrë parasysh instrumentet e tjera ndërkombëtare ligjore, që kanë lidhje me fushën e veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

duke marrë parasysh nevojën për përgatitjen e një instrumenti gjithëpërfshirës ndërkombëtar ligjor që fokusohet në të drejtat e viktimave të trafikimit dhe ndërtimin e një mekanizmi të veçantë monitorues; janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

KREU I

QËLLIMET, OBJEKTI, PARIMI I MOSDISKRIMINIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Qëllimet e Konventës

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) parandalimi dhe lufta e trafikimit të qenieve njerëzore, duke garantuar barazinë gjinore;

b) mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit, ndërtimi i një kuadri gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazinë gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive;

c) nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Me qëllim sigurimin e zbatimit efektiv të dispozitave të saj nga Palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm të veçantë monitorues.

Neni 2

Objekti

Kjo Konventë do të zbatohet për të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, qoftë kombëtare ose transnacionale, të lidhura apo jo me krimin e organizuar.

Neni 3

Parimi i mosdiskriminimit

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht pasjen e masave për të mbrojtur dhe nxitur të drejtat e viktimave, do të sigurohet pa diskriminuar për arsye të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina kombëtare apo sociale, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose një status tjetër.

Neni 4

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “Trafikim i qenieve njerëzore” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikatat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.

b) Kompromisi i një viktime të “trafikimit të qenieve njerëzore” në lidhje me shfrytëzimin e synuar, të parashtruar në nënparagrafin (a) të këtij neni, nuk do të jetë i vlefshëm kur është përdorur ndonjë nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a).

c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikim i qenieve njerëzore” edhe nëse kjo nuk përfshin një nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a) të këtij neni.

d) “Fëmijë” do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt trafikimi qeniesh njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen.

e) “Viktimë” do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen.

KREU II

PARANDALIMI, BASHKËPUNIMI DHE MASA TË TJERA

Neni 5

Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore

1. Çdo Palë do të marrë masa për të përcaktuar ose forcuar koordinimin kombëtar midis organeve të ndryshme përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Çdo Palë do të vendosë dhe/ose forcojë politikatat dhe programet efektive, për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore me anë të mënyrave të tilla si: kërkimi, informacioni, ndërgjegjësimi dhe fushatat arsimore, nismat shoqërore e ekonomike, dhe programet e trajnimit, veçanërisht për personat e ndjeshëm ndaj trafikimit dhe për profesionistë të interesuar mbi çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Çdo Palë do të nxisë përjasjen e bazuar te të drejtat e njeriut dhe do të përdorë çdo përjasje tjetër gjinore dhe që lidhet ngushtë me fëmijët, në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe

programeve të referuara në paragrafin 2.

4. Çdo Palë do të marrë masat e duhura, sipas nevojës, për të siguruar migrimin që të bëhet në mënyrë të ligjshme, veçanërisht nëpërmjet bërjes publike të informacionit të saktë nga zyrat përkatëse, mbi kushtet që mundësojnë hyrjen e ligjshme dhe qëndrimin në territorin e vet.

5. Çdo Palë do të marrë masa të posaçme për të ulur ndjeshmërinë e fëmijëve ndaj trafikimit, veçanërisht duke krijuar një mjedis mbrojtës për ta.

6. Masat e vendosura sipas këtij neni do të përfshijnë, sipas nevojës, organizatat joqeveritare, organizata e tjera të ngjashme dhe elemente të tjera të shoqërisë civile, të angazhuar në lidhje me parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen ose ndihmesën ndaj viktimave.

Neni 6

Masa për të shkruajtur kërkesën për këtë lloj veprimtarie

Për të shkruajtur kërkesën për aktivitetin që nxit të gjitha format e shfrytëzimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve që çon në trafikim, çdo Palë do të miratojë ose forcojë masat legjislative, administrative, arsimore, shoqërore, kulturore dhe masa të tjera, që përfshijnë:

- a) kërkimin mbi praktikën, metodat dhe strategjitë më optimale;
- b) ndërgjegjësimin në lidhje me përgjegjësinë dhe rolin e rëndësishëm të medias dhe shoqërisë civile në identifikimin e aktivitetit, si një nga shkaqet e origjinës së trafikimit të qenieve njerëzore;
- c) fushatat e informacionit të synuar, që përfshijnë, sipas nevojës, midis të tjerash, autoritetet publike dhe politikëbërësit;
- d) masat parandaluese, që përfshijnë programe edukimi për djem dhe vajza gjatë shkollimit të tyre, të cilat theksojnë natyrën e papranueshme të diskriminimit gjinor dhe pasojat e tij shkatërrimtare, rëndësinë e barazisë gjinore dhe dinjitetin e personalitetin e çdo qenieje njerëzore.

Neni 7

Masat në kufi

1. Pa cenuar angazhimet ndërkombëtare në lidhje me lëvizjen e lirë të njerëzve, Palët do të forcojnë, sa më shumë të jetë e mundur, ato kontrolle kufitare që mund të jenë të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Çdo Palë do të miratojë masat legjislative ose masat të tjera të përshtatshme për të parandaluar sa më shumë të jetë e mundur përdorimin e mjeteve të transportit të përdorura nga agjenci tregtare transporti për kryerjen e veprave penale, të përcaktuara sipas kësaj Konvente.

3. Kur të jetë e mundur dhe pa cenuar konventat ndërkombëtare të zbatueshme, këto masa do të përfshijnë vendosjen e detyrimit të agjencive tregtare të transportit, duke përfshirë çdo kompani transporti ose pronarin apo operatorin e çdo mjeti transporti, për t'u siguruar që të gjithë pasagjerët të kenë dokumentet e kërkuara të udhëtimit për hyrjen në shtetin pritës.

4. Çdo Palë do të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, për të parashikuar sanksione në rast të shkeljes së detyrimit të parashtruar në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës për të lejuar, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, ndalimin e hyrjes ose anulimin e vizave të personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale, të përcaktuara sipas kësaj Konvente.

6. Palët do të forcojnë bashkëpunimin mes agjencive të kontrollit kufitar, midis të tjerash, duke vendosur dhe mbajtur rrugë të drejtpërdrejta komunikimi.

Neni 8

Siguria dhe kontrolli i dokumenteve

Çdo Palë do të miratojë masa, sipas nevojës:

a) për të siguruar që dokumentet e udhëtimit ose identitetit të lëshuara nga ajo, të jenë të një cilësie që të mos të shpërdorohen e falsifikohen lehtësisht ose të mos modifikohen, të mos kopjohen apo lëshohen në mënyrë të paligjshme, si dhe

b) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e dokumentit ose dokumenteve të identitetit të lëshuara nga Pala ose në emër të Palës dhe për të parandaluar krijimin dhe lëshimin e tyre në mënyrë të paligjshme.

Neni 9
Legjitimiteti dhe vlefshmëria e dokumenteve

Me kërkesë të një Pale tjetër, çdo Palë, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, do të verifikojë brenda një kohe të arsyeshme legjitimitetin dhe vlefshmërinë e dokumenteve të udhëtimit ose identitetit, të lëshuara ose të synuara të lëshohen në emër të saj dhe që dyshohen se do të përdoren për trafikimin e qenieve njerëzore.

KREU III
**MASAT PËR MBROJTJEN DHE NXITJEN E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE,
DUKE GARANTUAR BARAZINË GJINORE**

Neni 10
Identifikimi i viktimave

1. Çdo Palë do t'u sigurojë autoriteteve të veta kompetente persona të trajnuar dhe të kualifikuar në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në identifikimin dhe ndihmën ndaj viktimave, duke përfshirë fëmijët dhe do të sigurojë që autoritetet e ndryshme bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si dhe me organizata të ngjashme mbështetëse, në mënyrë që viktimat të mund të identifikohen me një procedurë që merr parasysh situatën e veçantë të viktimave gra dhe fëmijë dhe në raste të përshtatshme, i pajis me lejet e qëndrimit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 14 të kësaj Konvente.

2. Çdo Palë do të miratojë këto masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të identifikuar viktimat, në bashkëpunim me palët e tjera dhe organizatat e ngjashme mbështetëse. Secila Palë do të sigurojë që, nëse autoritetet kompetente kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se një person ka qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ai person nuk do të largohet nga territori i saj derisa autoritetet kompetente të kenë kryer procesin e identifikimit si viktimë e një shkeljeje, të parashikuar në nenin 18 të kësaj Konvente dhe gjithashtu do të sigurojë që personi të marrë ndihmën e parashikuar në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.

3. Kur mosha e viktimës nuk dihet dhe ka arsye të besohet që viktima është fëmijë, ai ose ajo do të prezumohet të jetë një fëmijë dhe do t'i sigurohen masa të posaçme mbrojtëse, në pritje të verifikimit të moshës së tij/saj.

4. Pas identifikimit të një fëmije të parashikuar si viktimë, çdo Palë:

- a) do të parashikojë përfaqësimin e fëmijës nga një kujdestar ligjor, organizatë ose autoritet ligjor që do të veprojë në emër të interesave më optimale të këtij fëmije;
- b) do të marrë hapat e nevojshëm për të përcaktuar identitetin dhe kombësinë e tij/saj;
- c) do të bëjë çdo përpjekje për të lokalizuar familjen e tij/saj, kur kjo është në interesat më optimale të fëmijës.

Neni 11
Mbrojtja e jetës private

1. Çdo Palë do të mbrojë jetën private dhe identitetin e viktimave. Të dhënat personale në lidhje me ta do të ruhen dhe përdoren në përputhje me kushtet e parashikuara nga Konventa për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale (ETS No 108).

2. Çdo Palë do të miratojë masa për të siguruar në mënyrë të veçantë që identiteti ose detajet që lejojnë identifikimin e një fëmije, viktimë e trafikimit, të mos bëhen publike nëpërmjet medias ose çdo mjeti tjetër, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, me qëllim që të lehtësojë gjurmimin e anëtarëve të familjes ose të sigurojë mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës.

3. Çdo Palë do të marrë në konsideratë miratimin e masave në zbatim të nenit 10 të Konventës për mbrojtjen e qenieve njerëzore dhe lirive themelore, siç interpretohet nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut që synon nxitjen e medias për të mbrojtur jetën private dhe identitetin e viktimave nëpërmjet vetërregullimit ose masave rregullatore apo bashkërregullatore.

Neni 12
Ndihma për viktimat

1. Çdo Palë do të miratojë ato masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të ndihmuar

viktimat në rikuperimin e tyre fizik, psikologjik dhe shoqëror. Kjo asistencë do të përfshijë minimalisht:

- a) standardet për të siguruar jetesën e tyre, nëpërmjet masave të tilla si: akomodimi i përshtatshëm dhe i sigurt, ndihmë psikologjike dhe materiale;
- b) akses në trajtimin e emergjencës mjekësore;
- c) shërbime përkthimi dhe interpretimi sipas nevojës;
- d) konsulencë dhe informacion, veçanërisht për sa u përket të drejtave të tyre të ligjshme dhe shërbimeve në dispozicion të tyre, në një gjuhë që ata mund ta kuptojnë;
- e) asistencë për të mundësuar paraqitjen e të drejtave dhe interesave të tyre, si dhe shqyrtimin e tyre në fazat e përshtatshme të procedimit penal kundër shkelësve;
- f) akses në arsimin e fëmijëve.

2. Çdo Palë do të marrë në konsideratë sigurinë e viktimës dhe nevojat për mbrojtje.

3. Për më tepër, çdo Palë do të sigurojë asistencë të nevojshme mjekësore ose ndihmë tjetër për viktimat që banojnë në mënyrë të ligjshme brenda territorit të saj, të cilët nuk kanë burime të mjaftueshme dhe kanë nevojë për këtë ndihmë.

4. Çdo Palë do të miratojë rregullat, sipas të cilave viktimat që banojnë ligjërisht brenda territorit të saj, do të autorizohen të kenë akses në tregun e punës, në trajnimin profesional dhe arsimin.

5. Çdo Palë do të marrë masat e duhura sipas kushteve të parashikuara nga legjislacioni i saj i brendshëm, për të bashkëpunuar me organizata joqeveritare, me organizata të tjera të ngjashme ose elementë të tjerë të shoqërisë civile, të angazhuar në ndihmesën e viktimave.

6. Çdo Palë do të miratojë ato masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që ndihma ndaj viktimës nuk bëhet e kushtëzuar me gatishmërinë e tij ose të saj për t'u thirrur si dëshmitar.

7. Për zbatimin e dispozitave të parashtruara në këtë nen, çdo Palë do të sigurojë që shërbimet të ofrohen mbi bazën e konsensusit dhe informimit, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të personave në një pozitë të pafuqishme dhe të drejtat e fëmijëve në lidhje me akomodimin, edukimin dhe kujdesin e përshtatshëm shëndetësor.

Neni 13

Periudha e rikuperimit dhe reflektimit

1. Çdo Palë do të sigurojë në legjislacionin e saj të brendshëm një periudhë rikuperimi dhe reflektimi prej të paktën 30 ditësh, kur ka shkaqe të arsyeshme të besojë se personi i interesuar është viktimë. Kjo periudhë do të jetë e mjaftueshme për personin e interesuar që të rikuperohet dhe largohet nga ndikimi i trafikantëve dhe/ose të marrë një vendim të mirinformuar për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente. Gjatë kësaj periudhe, nuk do të ketë mundësinë të zbatojë asnjë urdhër dëbimi kundër tij ose saj. Kjo dispozitë nuk cenon aktivitetet e kryera nga autoritetet kompetente në të gjitha fazat e procedimit përkatëse të brendshëm dhe në veçanti kur kjo vepër penale po hetohet dhe ndiqet penalisht. Gjatë kësaj periudhe, Palët do të autorizojnë personat e interesuar të qëndrojnë në territorin e tyre.

2. Gjatë kësaj periudhe, personat e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të kenë të drejtën e gëzimit të masave të përfshira në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.

3. Palët nuk janë të detyruara të respektojnë këtë periudhë nëse situata e rendit publik e parandalon atë ose nëse zbulohet se statusi i viktimës është pretenduar në mënyrë të padrejtë.

Neni 14

Leja e qëndrimit

1. Çdo Palë do të lëshojë një leje qëndrimi të rinovueshme për viktimat në njërën ose tjetrën prej dy situatave të mëposhtme ose në të dyja këto situata:

a) autoriteti kompetent gjykon që qëndrimi i tyre është i nevojshëm për shkak të situatës së tyre personale;

b) autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm për qëllim të bashkëpunimit të tyre me autoritetet kompetente gjatë hetimit ose procedimit penal.

2. Leja e qëndrimit për viktimat fëmijë, kur është e nevojshme ligjërisht, do të lëshohet në përputhje me interesat më optimale të fëmijës dhe do të rinovohet në të njëjtat kushte, sipas nevojës.

3. Mosrinovimi ose tërheqja e një lejeje qëndrimi është objekt i kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i Palës.

4. Nëse një viktimë dorëzon një kërkesë për një lloj tjetër lejeje qëndrimi, Pala e interesuar do të marrë parasysh se ai ose ajo merr ose ka marrë një leje qëndrimi në përputhje me paragrafin 1.

5. Duke marrë në konsideratë detyrimet e Palëve që referohen në nenin 40 të kësaj Konvente, çdo Palë do të sigurojë që dhënia e një lejeje sipas kësaj dispozite, nuk do të cenojë të drejtën për të kërkuar dhe gëzuar strehim politik.

Neni 15

Kompensimi dhe zhdëmtimi ligjor

1. Çdo Palë do të sigurojë që viktimat, që prej kontaktit të tyre të parë me autoritetet kompetente, të kenë akses ndaj informacionit mbi procedimet e ngjashme gjyqësore dhe administrative, në një gjuhë të cilën ata mund ta kuptojnë.

2. Çdo Palë do të parashikojë në legjislacionin e saj të brendshëm të drejtën për ndihmë ligjore dhe konsulencë ligjore falas për viktimat në kushtet e parashikuara nga legjislacioni i saj i brendshëm.

3. Çdo Palë do të parashikojë në legjislacionin e saj të brendshëm të drejtën e viktimave për kompensim nga autorët e veprës penale.

4. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të garantuar kompensim për viktimat në përputhje me kushtet sipas legjislacionit të saj të brendshëm, për shembull nëpërmjet ngritjes së një fondi për kompensim ose masat apo programet e kompensimit, të synuara për asistencë sociale dhe integrimin social të viktimave që mund të financohen nga asetet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parashikuara në nenin 23.

Neni 16

Riatdhesimi dhe kthimi i viktimave

1. Pala nga e cila një viktimë është shtetas ose në të cilën ai person kishte të drejtën e qëndrimit të përhershëm në kohën e hyrjes në territorin e Shtetit pritës, duke pasur parasysh të drejtat e tij ose të saj, sigurinë dhe dinjitetin, do të lehtësojë dhe pranojë kthimin e tij ose të saj pa vonesa të tepruara ose të paarsyeshme.

2. Kur një Palë kthen një viktimë në një shtet tjetër, ky kthim preferohet të jetë vullnetar dhe do të marrë në konsideratë të drejtat, sigurinë dhe dinjitetin e atij personi dhe statusin e çdo procedimi ligjor në lidhje me faktin që personi është viktimë.

3. Me kërkesë të Palës pritëse, Pala e kërkuar do të verifikojë nëse një person është shtetas i saj ose ka pasur të drejtën e qëndrimit të përhershëm në territorin e saj në kohën e hyrjes në territorin e Palës pritëse.

4. Me qëllim lehtësimin e kthimit të viktimës që është pa dokumente të rregullta, Pala nga e cila ai person është shtetas ose në të cilën ai ose ajo kishte të drejtën e qëndrimit të përhershëm në kohën e hyrjes në territorin e Palës pritëse, do të bjerë dakord të lëshojë, me kërkesë të Palës pritëse, dokumente udhëtimi ose autorizim tjetër sipas nevojës, për t'i mundësuar personit të udhëtojë dhe të rihyjë në territorin e saj.

5. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të krijuar programe riatdhesimi, duke përfshirë institucione të ngjashme kombëtare ose ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare. Këto programe synojnë në shmangien e riviktimizimit. Çdo Palë duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të favorizuar riintegrimin e viktimave në shoqërinë e shtetit ku kthehet, duke përfshirë riintegrimin në sistemin arsimor dhe tregun e punës, në veçanti përmes përvetësimit dhe përmirësimit të aftësive të tyre profesionale. Për sa u përket fëmijëve, këto programe duhet të përfshijnë gëzimin e së drejtës për arsim dhe masat për të siguruar kujdes të mjaftueshëm ose marrjen në dorëzim nga familja apo strukturat e përshtatshme të kujdesit.

6. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative ose masa të tjera të nevojshme, për t'i mundësuar viktimave, sipas nevojës, në bashkëpunim me çdo Palë tjetër të interesuar, informacion kontakti të strukturave që mund t'i asistojnë në vendin ku ata janë kthyer ose riatdhesuar, si zyrat e zbatimit të ligjit, organizatat joqeveritare, profesionet ligjore që janë në gjendje të sigurojnë konsulencë dhe agjenci të asistencës sociale.

7. Viktimat fëmijë nuk do të kthehen në një shtet, nëse ka shenja se pas një rreziku dhe vlerësimi sigurimi, ky kthim nuk do të ishte në interesat më optimale të fëmijës.

Neni 17

Barazia gjinore

Çdo Palë, në zbatimin e masave të referuara në këtë kapitull, do të synojë të nxisë barazinë gjinore

dhe të përdorë për qasjen gjinore në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e masave.

KREU IV E DREJTA PENALE MATERIALE

Neni 18

Kriminalizimi i trafikimit të qenieve njerëzore

Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të përcaktuar si vepra penale sjelljen e përfshirë në nenin 4 të kësaj Konvente, kur kryhet qëllimisht.

Neni 19

Kriminalizimi i përdorimit të shërbimeve të një viktime

Çdo Palë do të marrë në konsideratë masa legislative dhe masa të tjera, sipas nevojës për të përcaktuar si vepra penale, sipas legjislacionit të saj të brendshëm, përdorimin e shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit, siç referohen në nenin 4 paragrafi “a” i kësaj Konvente, me dijeninë që personi është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.

Neni 20

Kriminalizimi i akteve në lidhje me dokumentet e udhëtimit ose identitetit

Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës për të përcaktuar si vepra penale sjelljet e mëposhtme, kur kryhen qëllimisht dhe me synim mundësimin e trafikimit të qenieve njerëzore:

- a) falsifikimi i dokumentit të udhëtimit ose identitetit;
- b) marrjen në zotërim ose sigurimin e këtij dokumenti; dhe
- c) mbajtjen, heqjen, fshehjen, dëmtimin ose shkatërrimin e dokumentit të udhëtimit apo identitetit të një personi tjetër.

Neni 21

Tentativa dhe ndihmesa ose mbështetja për kryerjen e një veprë penale

1. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të përcaktuar si vepra penale kur kryhen qëllimisht, ndihmesën ose mbështetjen për kryerjen e ndonjëres prej veprave të përcaktuara sipas neneve 18 dhe 20 të kësaj Konvente.

2. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të përcaktuar si vepra penale kur kryhen qëllimisht, tentativat për të kryer veprat e përcaktuara sipas neneve 18 dhe 20, paragrafi a i kësaj Konvente.

Neni 22

Përgjegjësia e personave juridikë

1. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që një person juridik mund të konsiderohet përgjegjës për një vepër penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente, të kryer për qëllim përfitimi nga një person fizik, duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik që ka një pozicion drejtues brenda këtij personi juridik, bazuar në:

- a) një fuqi përfaqësimi nga personi juridik;
- b) një autoritet që merr vendime në emër të personit juridik; dhe
- c) një autoritet që ushtron kontroll brenda personit juridik.

2. Përveç rasteve që janë parashikuar në paragrafin 1, çdo Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik të mund të konsiderohet përgjegjës, kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik referuar në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e veprës penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente, për përfitim të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij.

3. Objekt i parimeve ligjore të Palës, përgjegjësia e personit juridik mund të jetë penale, civile ose administrative.

4. Kjo përgjegjësi nuk do të cenojë përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprën penale.

Neni 23

Sanksionet dhe masat

1. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që veprat penale të përcaktuara sipas neneve 18 dhe 21 të dënohen me sanksione efektive, në mënyrë proporcionale dhe bindëse. Këto sanksione do të vendosen për veprat penale të përcaktuara sipas nenit 18, kur kryhen nga persona fizikë, me dënime që përfshijnë heqjen e lirisë që mund të çojë në ekstradim.

2. Çdo Palë do të sigurojë që personat juridikë që janë përgjegjës sipas nenit 22, të jenë objekt i sanksioneve ose masave efektive, në mënyrë proporcionale dhe bindëse penale ose jo penale, duke përfshirë dhe sanksionet monetare.

3. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, që të mund të konfiskojë ose të privojë përfitimet dhe të ardhurat e siguruar nga veprat penale të përcaktuara sipas neneve 18 dhe 20, paragrafi a i kësaj Konvente ose pasurinë, vlera e së cilës i korrespondon këtyre të ardhurave.

4. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të mundësuar bllokimin e përkohshëm ose të përhershëm të çdo organizate që është përdorur për të kryer trafikimin e qenieve njerëzore, pa cenuar të drejtat në mirëbesim të palëve të treta ose për t'i mohuar shkelësit, përkohësisht ose përgjithmonë, ushtrimin e aktivitetit gjatë të cilit është kryer kjo veprë.

Neni 24

Rrethana rënduese

Çdo Palë do të sigurojë që rrethanat e mëposhtme të konsiderohen si rrethana rënduese në vendosjen e dënimit për veprat, sipas nenit 18 të kësaj Konvente:

- a) vepra me dashje ose nga pakujdesia flagrante ka rrezikuar jetën e viktimës;
- b) vepra është kryer kundër një fëmije;
- c) vepra është kryer nga një nëpunës shtetëror në kryerjen e detyrave të tij/saj;
- d) kur vepra është kryer brenda kuadrit të një organizate kriminale.

Neni 25

Dënime të mëparshme

Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera, që parashikojnë mundësinë për të marrë parasysh dënimet e formës së prerë të kaluara nga një Palë tjetër, në lidhje me veprat e përcaktuara sipas kësaj Konvente, kur përcaktohet dënimi.

Neni 26

Dispozita e mosdënimit

Çdo Palë, në përputhje me parimet bazë të sistemit të saj ligjor, do të parashikojë mundësinë e mosvendosjes së dënimit për përfshirjen e viktimave në aktivitete të paligjshme, në masën që ato kanë qenë të detyruara ta bëjnë këtë.

KREU V

HETIMI, NDJEKJA PENALE DHE LIGJI PROCEDURAL

Neni 27

Aplikimet *ex parte* dhe avokati i caktuar kryesisht

1. Çdo Palë do të sigurojë që hetimet ose ndjekja penale për veprat e përcaktuara sipas kësaj Konvente nuk do të varen nga kallëzimi ose akuza e ngritur nga viktimat, të paktën kur vepra është kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj.

2. Çdo Palë do të sigurojë që viktimat e një vepre penale në territorin e një Pale të ndryshme nga

ajo ku banojnë, mund të bëjnë një ankesë drejtuar autoriteteve kompetente të shtetit të vendbanimit të tyre. Autoriteti kompetent tek i cili është bërë kjo ankesë, në atë masë që nuk ka kompetencë në këtë aspekt, do ta transmetojë atë pa vonesë tek autoriteti kompetent i Palës, në territorin e të cilit është kryer vepra. Ankesa do të trajtohet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës në të cilën është kryer vepra.

3. Çdo Palë, me anë të masave legislative ose masave të tjera, në përputhje me kushtet e parashikuara nga legjislacioni i saj i brendshëm, do t'i sigurojë çdo grupi, fondacioni, shoqate ose organizate joqeveritare që synon luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore ose mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mundësinë për të asistuar/ose mbështetur viktimën, me miratimin e tij ose të saj gjatë procedimit penal, në lidhje me veprën e përcaktuar sipas nenit 18 të kësaj Konvente.

Neni 28

Mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të autoriteteve gjyqësore

1. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar mbrojtjen e duhur dhe efektive nga hakmarrja ose kërcënimi i mundshëm, veçanërisht gjatë dhe pas hetimit dhe ndjekjes penale të shkelësve për:

a) viktimat;
b) nëse është e nevojshme, personat që kallëzojnë vepra penale të përcaktuara sipas nenit 18 të kësaj Konvente ose që bashkëpunojnë me autoritetet hetuese apo proceduese;
c) dëshmitarët që japin dëshmi në lidhje me veprat penale të përcaktuara sipas nenit 18 të kësaj Konvente;

d) nëse është e nevojshme, anëtarët e familjes së personave të referuar në nënparagrafët a dhe c.

2. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar dhe ofruar lloje të ndryshme mbrojtjeje. Kjo mund të përfshijë mbrojtje fizike, transferim, ndryshim identiteti dhe asistencë për gjetjen e një pune.

3. Një viktme fëmijë do t'i sigurohet masa për një mbrojtje të posaçme, duke marrë në konsideratë interesat më optimale të fëmijës.

4. Çdo Palë do të miratojë masa legislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar kur është e nevojshme, mbrojtjen e duhur nga hakmarrja ose kërcënimi i mundshëm për anëtarët e grupeve, fondacioneve, shoqatave ose organizatave joqeveritare, të cilët kryejnë aktivitetet e parashtruara në nenin 27 paragrafi 3, veçanërisht gjatë dhe pas hetimit dhe ndjekjes penale të shkelësve.

5. Çdo Palë do të marrë në konsideratë hyrjen në marrëveshje me shtetet e tjera për zbatimin e këtij neni.

Neni 29

Autoritetet e specializuara dhe organet koordinuese

1. Çdo Palë do të miratojë masa të nevojshme për të siguruar që personat ose subjektet të jenë të specializuara në luftën kundër trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave. Këta persona ose subjekte do të kenë pavarësinë e nevojshme në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor të Palës, me qëllim që ata të jenë në gjendje të kryejnë funksionet e tyre efektivisht dhe pa presion të tepruar. Këta persona ose stafi i këtyre subjekteve do të kenë trajnim të mjaftueshëm dhe burime financiare për të kryer detyrat e tyre.

2. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për të siguruar koordinimin e politikave dhe veprimeve të departamenteve të tyre qeveritare dhe agjencive të tjera publike kundër trafikimit të qenieve njerëzore, sipas nevojës, nëpërmjet krijimit të organeve koordinuese.

3. Çdo Palë do të sigurojë ose zhvillojë më tej trajnimin për nëpunësit përkatës në lidhje me parandalimin dhe luftën e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë trajnim mbi të drejtat e njeriut. Trajnimi mund të jetë i bazuar mbi specifikat e agjencive dhe do të fokusohet sipas nevojës në metodat e përdorura për parandalimin e këtij trafikimi, ndjekjen penale të trafikantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave, duke përfshirë mbrojtjen e viktimave nga trafikantët.

4. Çdo Palë do të marrë në konsideratë emërimin e raportuesve kombëtarë ose mekanizmave të tjerë për monitorimin e aktiviteteve antitrafikim të institucioneve shtetërore dhe zbatimin e kërkesave të legjislacionit të brendshëm.

Neni 30

Procedimet gjyqësore

Sipas Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, veçanërisht neni 6, çdo Palë do të miratojë masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar gjatë procedimeve gjyqësore:

a) mbrojtjen e jetës private të viktimave dhe sipas nevojës, identitetin e tyre;

b) sigurinë e viktimës dhe mbrojtjen nga kërcënimi,

në përputhje me kushtet sipas legjislacionit të saj të brendshëm dhe në rastin e viktimave fëmijë, duke pasur kujdes të posaçëm për nevojat e tyre dhe sigurimin e të drejtës së tyre për masa të mbrojtjes së posaçme.

Neni 31

Juridiksioni

1. Çdo Palë do të marrë masa legjislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të vendosur juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente, kur vepra është kryer:

a) në territorin e saj; ose

b) në bordin e një anijeje që ngre flamurin e asaj Pale; ose

c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj Pale; ose

d) nga një prej shtetasve të saj ose nga një person pa shtetësi që ka banesën e tij ose të saj të përhershme në territorin e saj, nëse vepra është e dënueshme sipas të drejtës penale në vendin ku është kryer ose nëse vepra është kryer jashtë juridiksionit territorial të një shteti;

e) kundër njërit prej shtetasve të saj.

2. Çdo Palë, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë që rezervon të drejtën të mos zbatojë ose zbatojë vetëm në raste ose kushte specifike, rregullat e juridiksionit të parashtruara në paragrafët 1 (d) dhe (e) të këtij neni ose ndonjë pjesë të tij.

3. Çdo Palë do të miratojë masa sipas nevojës për të vendosur juridiksion mbi veprat e referuara në këtë Konventë, në rastet kur një shkelës i dyshuar është i pranishëm në territorin e saj dhe, nuk e ekstradon atë te një Palë tjetër, vetëm në bazë të kombësisë së tij/saj, pas një kërkesë për ekstradim.

4. Kur më shumë se një Palë pretendon juridiksion mbi një vepër të dyshuar të përcaktuar sipas kësaj Konvente, Palët e përfshira, sipas nevojës, do të konsultohen me qëllim vendosjen e juridiksionit të duhur për ndjekjen penale.

5. Pa cenuar normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton juridiksionin penal të ushtruar nga një Palë në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

KREU VI

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Neni 32

Parimet e përgjithshme dhe masat për bashkëpunimin ndërkombëtar

Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe nëpërmjet zbatimit të instrumenteve të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale, marrëveshjeve të arritura në bazë të legjislacionit uniform dhe të ndërsjellë dhe legjislacionit të brendshëm, sa më shumë të jetë e mundur, për qëllime të:

- parandalimit dhe luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore;

- mbrojtjes dhe sigurimit të ndihmës për viktimat; ose

- hetimit ose procedimit në lidhje me veprat penale të përcaktuara sipas kësaj Konvente.

Neni 33

Masat në lidhje me personat e rrezikuar ose të humbur

1. Kur një Palë, në bazë të informacionit që ka në dispozicion, ka shkaqe të arsyeshme të besojë se jeta, liria ose integriteti fizik i një personi të referuar në nenin 28 paragrafi 1, është në rrezik të menjëhershëm në territorin e një Pale tjetër, Pala që ka informacionin, në rast emergjence, do ta transmetojë pa vonesë te ky i fundit, në mënyrë që të marrë masat mbrojtëse të përshtatshme.

2. Palët në këtë Konventë mund të marrin në konsideratë forcimin e bashkëpunimit të tyre në kërkim të njerëzve të humbur, në veçanti të fëmijëve të humbur, nëse informacioni që kanë i bën të besojnë se ai/ajo është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë qëllim, Palët mund të lidhin me njëra-tjetrën marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 34 **Informacioni**

1. Pala e kërkuar do të informojë menjëherë Palën kërkuuese mbi rezultatin përfundimtar të veprimit të marrë sipas këtij kreu. Pala e kërkuar do të informojë menjëherë Palën kërkuuese mbi çdo rrethanë që e ka bërë të pamundur kryerjen e veprimit të kërkuar ose që ka shkaktuar vonesë të konsiderueshme.

2. Një Palë, brenda kufijve të legjislacionit të saj të brendshëm, pa kërkesë paraprake, mund t'i parashtojë një Palë tjetër informacion të përftuar brenda kuadrit të hetimeve të saj, kur gjykon që zbulimi i këtij informacioni mund të asistojë Palën pritëse për fillimin ose kryerjen e hetimeve apo procedimit në lidhje me veprat penale të përcaktuara sipas kësaj Konvente ose mund të çojë në një kërkesë për bashkëpunim nga ajo Palë sipas këtij kreu.

3. Para sigurimit të këtij informacioni, Pala ofruese mund të kërkojë që ky informacion të ruhet konfidencial ose të përdoret duke respektuar kushtet. Nëse Pala pritëse nuk mund të bjerë dakord me këtë kërkesë, do të lajmërojë palën ofruese, e cila më pas do të vendosë nëse informacioni duhet të sigurohet apo jo. Nëse Pala pritëse pranon informacionin, objekt të kushteve, kjo Palë do ketë detyrim ligjor për to.

4. I gjithë informacioni i kërkuar në lidhje me nenet 13, 14 dhe 16, i cili nevojitet për të siguruar të drejtat e akorduara nga këto nene, do të transmetohet pa vonesë me kërkesë të Palës së interesuar në lidhje me nenin 11 të kësaj Konvente.

Neni 35 **Bashkëpunimi me shoqërinë civile**

Çdo Palë do të nxisë autoritetet shtetërore dhe nëpunësit publikë të bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare, organizata të tjera të ngjashme dhe anëtarë të shoqërisë civile, në vendosjen e partneriteteve strategjike, me synim arritjen e qëllimit të kësaj Konvente.

KREU VII **MEKANIZMI MONITORUES**

Neni 36 **Grupi i ekspertëve mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore**

1. Grupi i ekspertëve mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore (këtu më poshtë referuar si "GRETA") do të monitorojë zbatimin e kësaj Konvente nga Palët.

2. GRETA do të përbëhet minimalisht prej 10 anëtarësh dhe maksimalisht prej 15 anëtarësh, duke marrë parasysh një ekuilibër gjinor dhe gjeografik, si dhe ekspertizën shumëdisiplinëshe. Ata do të zgjidhen nga Komiteti i Palëve për një mandat prej 4 vjetësh, i rinovueshëm një herë, të zgjedhur nga shtetasit e Shteteve Palë të kësaj Konvente.

3. Zgjedhja e anëtarëve të GRETA-s do të bazohet në parimet e mëposhtme:

a) ata do të zgjidhen nga persona me integritet të lartë moral, të njohur për kompetencën e tyre të shquar në fushën e të drejtave të njeriut, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave dhe masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ose që kanë përvojë profesionale në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;

b) ata do të kenë kapacitetin e tyre individual dhe do të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe do të jenë në dispozicion të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive;

c) nuk mund të jenë anëtarë të GRETA-s dy shtetas nga i njëjti shtet;

d) ata duhet të përfaqësojnë sistemet kryesore ligjore.

4. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GRETA-s do të vendoset nga Komiteti i Ministrave, pas konsultimit dhe marrjes së miratimit unanim të Palëve të Konventës, brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. GRETA do të miratojë rregullat e saj procedurale.

Neni 37
Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve do të përbëhet nga përfaqësues të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të Shteteve Anëtare, Palë të Konventës dhe përfaqësues të Palëve të Konventës, të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës.

2. Komiteti i Palëve do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Takimi i tij i parë do të mbahet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, me qëllim që të zgjedhë anëtarët e GRETA-s. Më pas, do të takohet sa herë që një e treta e Palëve, Presidenti i GRETA-s ose Sekretari i Përgjithshëm e kërkojnë këtë.

3. Komiteti i Palëve do të miratojë rregullat e tij procedurale.

Neni 38
Procedura

1. Procedura e vlerësimit do të përfshijë Palët e Konventës dhe do të ndahet në raunde, gjatësia e të cilave vendoset nga GRETA. Në fillim të çdo raundi, GRETA do të zgjedhë dispozitat e posaçme mbi të cilat do të bazohet procedura e vlerësimit.

2. GRETA do të përcaktojë mjetet më të përshtatshme për të kryer këtë vlerësim. GRETA në veçanti mund të miratojë një formular për çdo raund vlerësimi që mund të shërbejë si bazë për vlerësimin e zbatimit nga Palët e kësaj Konvente. Ky formular do t'i adresohet të gjitha Palëve. Palët do t'i përgjigjen këtij formulari, si dhe çdo kërkesë tjetër për informacion nga GRETA.

3. GRETA mund të kërkojë informacion edhe nga shoqëria civile.

4. GRETA mund të organizojë në bashkëpunim me autoritetet e brendshme dhe “personin e kontaktit” të emëruar nga ky i fundit dhe nëse është e nevojshme, me ndihmën e ekspertëve kombëtarë të pavarur, vizita nëpër vendet përkatëse. Gjatë këtyre vizitave, GRETA mund të asistohet nga specialistë në fusha specifike.

5. GRETA do të përgatisë një draftaport, që përmban analizën e saj mbi zbatimin e dispozitave mbi të cilat bazohet vlerësimi, si dhe sugjerimet dhe propozimet e saj në lidhje me mënyrën në të cilën Pala e interesuar mund të trajtojë problemet e identifikuara. Draftaporti do t'i dërgohet për komente Palës që kaloi vlerësimin. Komentet e saj merren në konsideratë nga GRETA, kur përcakton raportin e saj.

6. Mbi bazën e kësaj, GRETA do të miratojë raportin dhe konkluzionet e saj në lidhje me masat e marra nga Pala e interesuar për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente. Ky raport dhe konkluzionet përkatëse do t'i dërgohen Palës së interesuar dhe Komitetit të Palëve. Raporti dhe konkluzionet e GRETA-s do të bëhen publikë që nga miratimi i tyre, së bashku me komentet eventuale nga Pala e interesuar.

7. Pa cenuar procedurën e paragrafëve 1 deri 6 të këtij neni, Komiteti i Palëve mund të miratojë mbi bazën e raportit dhe konkluzioneve të GRETA-s, rekomandime të drejtuara kësaj Pale (a) në lidhje me masat që duhet të merren për të zbatuar konkluzionet e GRETA-s, nëse është e nevojshme, për të caktuar një datë për dorëzimin e informacionit mbi zbatimin e tyre dhe (b) duke synuar nxitjen e bashkëpunimit me atë Palë për zbatimin e duhur të kësaj Konvente.

KREU VIII
MARRËDHËNIA ME INSTRUMENTET E TJERA NDËRKOMBËTARE

Neni 39

Marrëdhënia me protokollin për të parandaluar, shtypur dhe dënuar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional

Kjo Konventë nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e protokollit për të parandaluar, shtypur dhe dënuar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe synon të rrisë mbrojtjen e ofruar nga ajo, si dhe të zhvillojë standardet e përfshira në të.

Marrëdhëniet me konventat dhe marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumente të tjera ndërkombëtare në të cilat Shtetet Palë në këtë Konventë janë Palë ose do të bëhen Palë dhe të cilat përmbajnë dispozita në çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, dispozita të cilat garantojnë një mbrojtje dhe asistencë më të madhe për viktimat e trafikimit.

2. Palët në Konventë mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, me qëllim të plotësimit ose përforcimit të dispozitave të kësaj ose për të lehtësuar të zbatimin e parimeve që ajo mishëron.

3. Shtetet Palë të cilat janë vende anëtare të Bashkimit Europian do të zbatojnë në marrëdhëniet ndërmjet tyre rregullat përkatëse të Bashkimit dhe Komunitetit Europian në atë shkallë që këto rregulla të Bashkimit dhe Komunitetit Europian rregullojnë dhe janë të zbatueshme për çështjen në fjalë pa paragjykuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente, si dhe paparagjykuar zbatimin e plotë të saj në marrëdhënie me Palët e tjera.

4. Asgjë në këtë Konventë nuk do të prekë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shteteve dhe individëve sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në veçanti, aty ku është e zbatueshme, Konventën e vitit 1951 dhe protokollin e vitit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe parimin “*non-refoulement*” që përmbahet aty.

**KREU IX
AMENDAMENTET**

**Neni 41
Amendamentet**

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente ndaj kësaj Konvente dhe çdo propozim do t'i komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës shteteve anëtare të Këshillit të Europës, çdo shteti që ka nënshkruar këtë Konventë, çdo Shteti Palë, Komunitetit Europian, çdo shteti që është ftuar të nënshkruajë këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 42, si dhe çdo shteti që është ftuar të aderojë në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 43.

2. Çdo amendament i propozuar nga një Palë do t'i komunikohet GRETA-s, i cili i paraqet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mendimin e vet për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave shqyrton amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga GRETA dhe pas konsultimit të Palëve në këtë Konventë dhe marrjes së miratimit të tyre unanim, mund të miratojë amendamentin.

4. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do t'u transmetohet Palëve për pranim.

5. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë, pasi të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se e kanë pranuar atë.

**KREU X
DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 42
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe për shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj.

2. Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës kur dhjetë shtete nënshkruese, nga të cilat të paktën tetë janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.

4. Për çdo shtet të referuar në paragrafin 1 ose Komunitetin European, i cili do të shprehë më pas pëlqimin e vet për t'iu bindur kësaj Konvente, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së shprehjes të pëlqimit për t'iu bashkuar Konventës në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.

Neni 43

Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit me Shtetet Palë të Konventës dhe miratimit të tyre unanim mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, për të aderuar në këtë Konventë me anë të një vendimi që merret me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me unanimitetin e përfaqësuesve të Shteteve Pale, që cilët gëzojnë të drejtën e anëtarit të Komitetit të Ministrave.

2. Për çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 44

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë. Konventa do të hyjë në fuqi për këtë territor ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mëparshëm mund të tërhiqet, përsa i takon çdo territori të caktuar në deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 45

Rezervat

Me përjashtim të rezervës së parashikuar në nenin 31 paragrafi 2, kësaj Konvente nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë tjetër.

Neni 46

Denoncimi

1. Çdo Palë mundet në çdo çast të denoncojë këtë Konventë, duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 47

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet që ka nënshkruar këtë Konventë, çdo Shtet Palë, Komunitetin European, çdo shtet që është ftuar të nënshkruajë këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 42, si dhe çdo shtet që është ftuar të aderojë në këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e nenit 43 për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e neneve 42 dhe 43 të saj;

d) çdo amendament të miratuar në përputhje me dispozitat e nenit 41, si dhe datën e hyrjes në fuqi;

e) çdo denoncim të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 46;

f) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë;

g) çdo rezervë të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 45;

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Varshavë, më 16 maj 2005, në një origjinal të vetëm, në gjuhët frënge dhe angleze, të dyja tekstet njëlloj të besueshme, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u dërgojë nga një kopje të vërtetuar secilit prej Shteteve anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetit Europian, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës, si dhe çdo shteti tjetër të ftuar për të aderuar në të.

LIGJ

Nr.9644, datë 20.11.2006

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9323, DATË 25.11.2004 “PËR BARNAT DHE SHËRBIMIN FARMACEUTIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 shtohen pikat 26 e 27 me këtë përmbajtje:

“26. “Çmimi CIF i importit” është çmimi (“Cost, Insurance, Freight”- Kosto, Sigurim, Shpenzime transporti), i përcaktuar për barin nga fabrikuesi deri në pikën doganore hyrëse në Republikën e Shqipërisë.

27. “Listë rimbursimi” është lista e barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.”.

Neni 2

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50

Çmimi i barnave dhe marzhet

1. Çmimi i barnave në treg është i kontrolluar dhe bazohet mbi çmimet CIF të importit dhe mbi bazën e çmimeve të fabrikimit për barnat e prodhuara në vend.

2. Kontrolli i çmimit të barnave në treg realizohet përmes marzheve të fabrikimit e të tregtimit, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Çmimet e barnave të listës së rimbursimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51

Komisioni i Çmimit të Barnave

1. Këshilli i Ministrave ngre Komisionin e Çmimit të Barnave, të përbërë nga:

- 2 përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
- 2 përfaqësues nga Ministria e Financave;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- 2 përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

2. Mënyra e funksionimit të këtij Komisioni përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shëndetësisë.”.

Neni 4

Shkronja “k” e nenit 57 ndryshohet si më poshtë:

“k) shkëlja e nenit 50, deklarimi i rremë i çmimeve CIF të importit dhe çmimeve të fabrikimit për barnat e prodhuara në vend, dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të shumës së llogaritur ndërmjet vlerës së deklaruar dhe çmimit real.

Shitja me çmime të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Komisioni i Çmimit të Barnave dënohet me 100 për qind të shumës së përfituar padrejtësisht dhe, në rast përsëritjeje, me heqje të licencës.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5149, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
...	
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 15.12.2006
Doli nga shtypi më 18.12.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë